

Logo ASHMDF

LOGO MPCSSHB

RAPORTI VJETOR I MONITORIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR FËMIJË 2012-2015

PËR PERIUDHËN

QERSHOR 2012 - MAJ 2013

Foto

HYRJE

Misioni ynë i përbashkët është të sigurojmë një nivel të përshtatshëm mirëqenieje, akses të pakushtëzuar për edukim dhe kujdes shëndetësor për të gjithë fëmijët, mbrojtje të veçantë për fëmijët në nevojë, viktime të abuzimit seksual, trafikimit, shfrytëzimit ekonomik dhe për fëmijët në konflikt me ligjin.

Plotësimi i kuadrit ligjor për fëmijët sipas standarteve ndërkombëtare, hartimi i dokumentave politikë për të siguruar realizimin e të drejtave të fëmijëve në vend, janë hapa të rëndësishëm për institucionet e shoqërinë tonë, por bashkë me këto zhvillime vjen edhe përgjegjësia për zbatimin dhe realizimin e tyre.

Ky raport vlerëson zbatueshmërinë dhe realizimin e objektivave sektoriale dhe masave ndërsektoriale, që sigurojnë bashkëpunimin e të gjithë aktorëve të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, të parashikuara në Planin të Veprimit për Fëmijë 2012-2015, për periudhën Qershor 2012 deri në Maj 2013.

Ndonëse raporti paraqet realizimin e objektivave të përcaktuar sipas fushave të të drejtave të fëmijëve, një fokus i veçantë është vendosur edhe në vlerësimin e situatës aktuale të funksionimit të mekanizmave vendorë për mbrojtjen e fëmijëve.

Duke konsideruar se ngritja e këtyre mekanizmave ligjorë është hapi i parë, më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm, nga ku fillon edhe implementimi i ligjit apo politikave për fëmijët, raporti synon të paraqesë stadin aktual si dhe problematikat e hasura në ngritjen dhe funksionimin e Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashkie/komune dhe Njësive për të Drejtat e Fëmijëve në nivel qarku

Megjithëse vlerësojmë se brenda këtij viti, është rritur ndjeshëm numri i bashkive dhe komunave që kanë ngritur Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve, nga ana e pushtetit vendor kërkohet më tepër përgjegjësi që ky proces të shtrihet në të gjithë vendin, si dhe të sigurohet mirëfunksionimi i këtyre strukturave për t'i dhënë përgjigje të shpejtë nevojave të fëmijëve, në komunitetet ku ato jetojnë.

Raporti është përgatitur në bazë të informacioneve të raportuara nga institucionet qendrore përgjegjëse për zbatimin e ligjit, njësitë për fëmijët në nivel qarku/bashki/komunë dhe shoqëria civile.

KAPITULLI 1

E DREJTA PËR MBROJTJE DHE PËRFSHIRJE SOCIALE

Rritja e rolit të njësive të qeverisjes vendore, në vlerësimin e nevojave të fëmijëve në raport me realizimin e të drejtave të tyre dhe zbutjen e varfërisë.

Një nga drejtimet kryesore të Planit të Veprimit për Fëmijë 2012-2015 ka të bëjë me nxitjen e hartimit të politikave gjipërfshirëse për fëmijët në nivel vendor.

Në këtë kuadër të gjitha qarqet janë nxitur për të hartuar politika rajonale për të drejtat e fëmijëve në përputhje me nevojat specifike të secilit qark.

Me mbështetjen e UNICEF ka filluar puna për hartimin e strategjive rajonale:

- 6 qarqe kanë miratuar Strategjitë Rajonale për të Drejtat e Fëmijëve, me vendim të Këshillave të Qarqeve
- 4 qarqe janë në procesin e hartimit të draft - strategjisë
- qarku Korçe ka përfunduar afati i strategjisë duhet të fillojnë hartimi i strategjisë re
- qarku Durrës nuk ka nisur akoma procesin.

Një aspekt i rëndësishëm është edhe monitorimi i zbatueshmërisë së këtyre strategjive, ku rezulton se qarqet kanë nevojë të rrisin kapacitetet e tyre për të siguruar zbatueshmërinë e strategjive rajonale si dhe monitorimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të përmirësimit të politikave sociale për zbutjen e varfërisë, MPÇSSHB në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore ka vendosur të pilotojë për një periudhë 2 vjecare, një mënyre e re për vlerësimin e familjeve që duan të marrin ndihmë ekonomike. Pilotimi do të shtrihet në qarkun e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit, ku është vendosur rreth gjysma e popullsisë së vendit.

Duke vlerësuar se skema aktuale NE ka disa proçedura përjashtuese për familjet e varfëra, u ndërmorën disa inisiativa për ndryshime në legjislacionin e NE. Me miratimin e VKM nr. 904, datë 12.12.2012, përcaktohet mënyra e re e aplikimit dhe përzgjedhjes së familjeve përfituese. Sipas skemës së re proçedurat e aplikimit për NE janë më të thjeshta dhe informacioni për cdo familje aplikuese do të përpunohet sipas një formule pikëzimi.

Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale për fëmijë


Në kuadër të reformës së sistemit të shërbimeve sociale është ndërmarrë edhe transformimi i qendrave rezidenciale, në modelin Shtëpi Familje.

Gjatë 2012 përfundoi rikonstrukcioni i Shtëpisë së Fëmijës 6-16 vjeç “Zyber Hallulli” në Tiranë. Ky institucion ka transformuar shërbimin rezidencial në shërbim të formës Shtëpi Familje. 38 fëmijët janë vendosur në 4 apartamente të ndarë.


Aktualisht në gjithë rrjetin e institucioneve të përkujdesit për fëmijë ekzistojë rreth 12 shërbime të llojit Shtëpi –Familje. 10 nga këto shërbime ofrohen nga OJF, ndërsa 2 janë shërbime publike.

Gjatë vitit 2012 u mbështeten me fonde nga buxheti i shtetit dhe ekspertizë 19 shërbime rezidenciale të përkujdesit shoqëror. Gjatë 2012 janë ngritur me fonde nga qeverisja vendore dhe MPÇSSHB, 2 qendra të përkujdesit shoqëror për fëmijët autik në Elbasan dhe Gjirokastrë.

Në total shërbimet rezidenciale dhe ditore për fëmijë ofrohen në 106 qendra. 16 prej tyre janë shërbime publike dhe 90 ose rreth 85 % e shërbime për fëmijë ofruet jo publikë shërbimesh sociale, të cilët kryesisht janë OJF.



Burimi: SHSSH



Burimi: SHSSH

Numri më i madh i shërbimeve për fëmijë është e përqendruar ne qarkun e Tiranës e më pas vijnë qarqet Shkodër, Elbasan, Durrës.

Nga takimet me institucionet vendore, aktorët që veprojnë në terren për mbrojtjen e fëmijëve është theksuar nevoja për rritjen e numrit dhe llojshmërisë së shërbimeve sociale për fëmijë.

Gjatë vitit 2012- mars 2013, në rrjetin e Institucioneve Publike dhe Jopublike të Përkujdesit Shoqëror për fëmijë janë trajtuar:

- **566 fëmijë** në Institucione Rezidenciale të Përkujdesit për fëmijë (**279 fëmijë** në 9 institucionet publike, **387 fëmijë** në 13 institucionet jopublike (OJF- të);
- **7086 fëmijë** trajtohen me shërbime ditore/komunitare. Ky lloj shërbimi ofrohet në 2 Institucione Publike dhe 73 qendra ditore jopublike (OJF-të)

Në kuadër të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar për fëmijët në qendra rezidenciale, SHSSH në bashkëpunim me Organizatën Terre des hommes në Shqipëri, nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi që synon të mbështesë punën e institucioneve rezidenciale për fëmijë në bashkitë Tiranë, Durrës, Sarandë dhe Vlorë.

Në fokus të bashkëpunimit ka qënë trainimi i stafeve të institucioneve me qëllim rritjen e aftësive profesionale në punën e drejtpërdrejtë me fëmijët, si dhe nxitjen dhe përmirësimin e praktikave të punës duke promovuar interesin më të lartë të fëmijëve dhe respektimin e të drejtave të tyre

Mbrojtje alternative për fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror

Kujdestria

Në zbatim të VKM Nr 89 datë 26.01.2012 “ Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurës së shërbimit të kujdestarisë” dhe udhëzimit Nr 6 datë 01.08.2012 në zbatim të kësaj VKM, vazhdon pilotimi i shërbimit të kujdestarisë në qarqet Tiranë, Shkodër. 66 fëmijë pa kujdes prindëror të moshës 0- 18 vjeç, janë vendosur në familje kujdestare.

Masa e financimit për familjen kujdestare, për shpenzimet e ushqimit të një fëmije në kujdestari, është 9 000 lekë në muaj, ndërkohë që familja kujdestare përfiton edhe pagesa vjetore lidhur me veshmbathjen e fëmijës, shpenzimeve për shkollën etj. Shpenzimet përballohen nga buxheti i shtetit.

Birësimi

Gjatë vitit 2012 deri në prill 2013 janë realizuar 79 birësime ndër këto:

- 49 janë birësime vendase
- 30 janë birësime ndërvendase të realizuara nëpërmjet Agjencive Ndërmjetësuese Ndërkombëtare të licensuara dhe autoriteteve qendrore të vendeve me të cilat vendi ynë bashkëpunon në fushën e birësimit në bazë të Konventës së Hagës. Fëmijët e birësuar jashtë vendit kryesisht kanë qënë me probleme shëndetësore, me moshë relativisht të rritur dhe të përkatësive të tjera etnike, kryesisht rome.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve bën monitorime pranë institucioneve të përkujdesit rezidenciale publike dhe jo publike, me qëllim zbatimin e afateve ligjore për fillimin e procedurave për birësim.

Monitorimet e KSHB shtrihen edhe në periudhën pasbirësuese. Në bazë të një marrëveshjeje të brendshme, ndërmjet aplikantëve birësues dhe Komitetit Shqiptar të Birësimeve, për një periudhë 2 vjeçare realizohen cdo 6 muaj, raporte per periudhën pasbirësuese. Për fëmijët e birësuar jashtë vendit, raportet pasbirësuese realizohen nga punonjësit socialë të vendeve pritëse. Gjatë vitit 2012 janë realizuar raportet pasbirësuese të 40 fëmijëve.

Harmonizimi i politikave për të drejtat e fëmijëve nëpërmjet funksionimit të mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Në 3 Shtator 2012 u mbajt mbledhja e parë e Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Këshilli kryesohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe ka në përbërje 13 anëtarë, 9 ministra të kabinetit, 1 Përfaqësues nga Avokati i Popullit, 1 Përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga Shoqëria Civile. Në takim u diskutuan arritjet e deritanishme, problematika e çështjeve të fëmijëve dhe ecuria në vazhdim.

Njësitë për të Drejtat e Fëmijëve (NJDF)

Njësitë e të Drejtave të Fëmijëve janë ngritur dhe funksionojnë si pjesë e administratës së Këshillave të Qarqeve në të gjithë qarqet e vendit (12 NJDF). Qarqet e Gjirokastrës dhe Korçës janë 2 qarqet e fundit që ngritën NJDF në fund të 2012.

NJDF vlerësohet se kanë pasur një rol të rëndësishëm në nxitjen e aktorëve lokalë për të bashkëpunuar në funksion të realizimit të të drejtave të fëmijëve brenda qarqeve respektive si nxitjen e bashkive/komunave për ngritjen e NJMF të reja në zbatim të ligjit 10347 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve”.

Në qarqe janë ngritur dhe funksionojnë Komitetet Drejtuese, të cilët drejtohen nga Kryetarët e Qarqeve. Në këto Komitete janë anëtarë pothuajse të gjithë drejtuesit e institucioneve vendore, kryetarët e bashkive/komunave të cilët shqyrtojnë problematikat e fëmijëve në qark, dhe detyrimeve institucionale të secilit për zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.

Ministria e Shëndetësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, nëpërmjet Udhërave përkatës kanë udhëzuar stafin e tyre në nivel vendor për pjesmarrje në Komitetet Drejtues dhe Grupet Teknike Multidisiplinare për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor.

ASHMDF ka përgatitur dhe shpërndarë në cdo qark rregulloren TIP të funksionimit të Komiteteve Drejtues, e cila është miratuar me Vendim të Këshillave të Qarqeve.


Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF)

Deri tani janë ngritur dhe funksionojnë 154 Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve në nivel bashkie/komune. Për periudhën maj 2012 – maj 2013 janë ngritur 105 NJMF të reja, ose rreth 68 % e numrit total të NJMF të ngritura deri tani.


NJMF janë ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë/Komunës apo me Vendim të Këshillit Bashkiak/Komunal dhe janë pjesë e organigramës së bashkisë/komunës. Të gjithë pagat e NJMF sigurohen nga buxheti i njësisve vendore respektive.

Me Vendim Nr. 23, datë 09 .04. 2013, të Këshillit Bashkiak të Tiranës, pranë çdo Njësie Bashkiake do të emërohet Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës. Vendimi përcakton buxhetin e nevojshëm për emërimin e këtyre punonjësve dhe përcakton se është Bashkia e Tiranës që

emëron Punonjësën për Mbrojtjen e Fëmijës pranë çdo Njësie Bashkiake. Pritet zbatimi i këtij vendimi.



Burimi: ASHMDF



Burimi: ASHMDF

Përqindjen më të madhe të mbulimit me NJMF e kanë qarqet Durrës më 94%, Vlorë 89%, Elbasan 74%. Ndërsa qarqet Gjirokastrë dhe Korçë kanë përqindjen e mbulimit më të vogël.

Duke marrë parasysh se, numri aktual i NJMF të ngritura është 154 NJMF, në krahasim me 49 NJMF të raportuara nga ASHMDF 1 vit më parë, vlerësojmë se në përgjithësi procesi i ngritjes së NJMF ka ecur me ritme të shpejta.

Duke konsideruar se ngritja e NJMF është hapi i parë, më i rëndësishëm dhe më i domosdoshëm, nga ku fillon edhe implementimi i ligjit apo mbrojtja e fëmijëve, ASHMDF ka ndërmarrë takime me funksionarë vendorë, aktivitete sensibilizuese si dhe ka nxitur në mënyrë të vazhdueshme NJMF në qarqe për të ndikuar në vendimmarrjen e kryetarëve të bashkive/ komunave për të vlerësuar ngritjen e NJMF si një detyrim ligjor, por edhe si domosdoshmëri për mbështetjen e fëmijëve dhe komuniteteve që ata përfaqësojnë.

Nga monitorimet e deritanishme rezulton se të gjithë aktorët vendorë vlerësojnë rolin e NJMF, si struktura kryesore ku referohen për ndjekje rastet e fëmijëve në rrezik. Efikasiteti i punës së NJMF është i kufizuar për shkak të burimeve të kufizuara teknike e financiare si dhe kapacitetit të kufizuar profesional të vetë NJMF për të ushtruar detyrën.

Sipas **VKM Nr. 265 datë 12.04.2012** *“Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”*, **kreu II.** *“Procedura për ndërhyrjen në ndihmë të fëmijëve në rrezik”*, nenet 10 dhe 11, NJMF bashkë me policinë dhe SHSSH merr në mbrojtje të menjëhershme çdo fëmijë që gjendet në situatë emergjente dhe i ofron strehim, ushqim, kujdes shëndetësor dhe mbështetje ligjore në mënyrë të menjëhershme.

Aktualisht buxheti i përcaktuar për funksionimin e NJMF është vetëm buxheti që mbulon pagën e punonjësit. Nuk është përcaktuar asnjë buxhet tjetër për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik nga këto struktura, duke mos i dhënë mundësi NJMF të ndërhyjë shpejt e në mënyrë të duhur, veçanërisht në rastet emergjente.

Duke marrë parasysh që NJMF janë ngritur në periudha të ndryshme kohore (disa nga NJMF kanë rreth 6 vjet që funksionojnë), niveli profesional i NJMF është i ndryshëm, bazuar kjo edhe në trainimet e ndryshme që kanë marrë dhe pëvojën që disa nga NJMF kanë akumuluar në vite. Ndryshimet ndërmjet NJMF-ve vihen re në mënyrë dhe efektivitetin e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, mbledhjen dhe koordinimin e të gjithë aktorëve në nivel lokal si dhe në aftësinë për të evidentuar dhe përdorur të gjitha burimet njëzëre dhe financiare brenda juridiksionit të tyre.

Ka pasur disa iniciativa nga Terre des hommes për rritjen e kapacitetit të NJMF të reja, megjithatë ngritja e kapaciteteve profesionale të NJMF duhet të jetë një proces në vazhdimësi, i mirëkordinuar për t'i dhënë mundësi formimi profesional jo vetëm NJMF-ve të reja, por edhe për të rritur kapacitetin profesional të NJMF me përvojë.

Së fundi është duke u diskutuar nënshkrimi i një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet MPÇSSHB, MB, Fakultetit të Shkencave Sociale dhe një grup OJF, për të realizuar trajnimin e një grup punonjësish socialë që punojnë me fëmijët sipas një kurrikule të përcaktuar me tematika për mbrojtjen e fëmijëve. Periudha e trainimit mendohet të zgjasë për 1 vit dhe pa shkëputje nga puna për pjesëmarrësit.

Ngritja e kapaciteteve të administratës vendore lidhur me realizimin e të drejtave të fëmijëve

Bazuar në nenin 37 të ligjit “Për të Drejtat e Fëmijëve” ASHMDF ka përgjegjësinë për të realizuar veprimtari trainuese, ndërgjegjësuës për punonjësit e administratës publike për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Gjatë periudhës Nëntor 2012- maj 2013 ASHMDF në bashkëpunim me UNICEF ka organizuar trainime 2 ditore në të 12 qarqet e vendit, lidhur me njohjen, sensibilizimin e aktorëve në nivel vendor lidhur me politikat e reja kombëtare për realizimin e të drejtave të fëmijëve.

Trainimi ka përcjellë njohuri mbi Planin e Veprimit për Fëmijë 2012-2015, politikat e përfshirjes sociale të fëmijëve vulnerabël, ligjin “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, dhe 5 aktet nënligjore në zbatim të tij. Trainimi ka pasur në focus administratën vendore

Në të 12 qarqet janë trainuar 430 persona në total, prej tyre:

- 265 përfaqësues të institucioneve rajonale, si: Drejtoria e rrethit të Shëndetit Publik, Drejtoria Rajonale e Arsimit SHSSH Rajonal, Drejtoria Rajonale e Policisë, Zyrat e Punës, Prefekturat.
- 90 NJMF
- 75 përfaqësues nga OJF që ofrojnë shërbime për fëmijë në komunitet.

Janë të nevojshme edhe trainime të tjera më të specifikuar

KAPITULLI 2

E DREJTA PËR MBROJTJE NGA DHUNA, ABUZIMI DHE SHFRYTËZIMI EKONOMIK

Parandalimi

Është punuar për përmirësimin e akteve nënligjore të ligjit “Për gjendjen civile”, duke pasur në vëmendje regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar.

- **Udhëzimi Nr. 7, datë 10.01.2012** “Për miratimin e procedurës dhe të procesverbaleve që do të plotësohen nga përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe të bashkive/njësive bashkiake/komunave për rastet e fëmijëve të gjetur dhe fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile”. Nëpërmjet këtij Udhëzimi, synohet ulja dhe eliminimi i rasteve të paregjistruara të fëmijëve të gjetur dhe të braktisur nga nëna.

- Në zbatim të Udhëzimit të mësipërm, me **Urdher Nr.173 Prot, date 27.04.2012**, te Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, janë miratuar Procedurat Standarte për "Regjistrimin e Fëmijëve të Paregjistruar në Gjendjen Civile". Këto Procedura Standarde i janë dërguar për zbatim të gjitha Drejtorive të Policisë në Qarqe, për të vijuar bashkepunimin me strukturat e pushtetit lokal me qëllim regjistrimin e fëmijëve në gjendjen civile.

- **Marrëveshja e Përbashkët** ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe qendrës “Shërbimi Ligjor Falas” në 2011 për të facilituar regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pengesë për të cilën kanë qenë mungesa e aktit të lindjes ose dokumentacionit tjetër të nevojshëm nga ana e prindërve. Në bazë të kësaj Marrëveshjeje, shërbimet konsullore shqiptare sigurojnë dokumentacionin nga shërbimi shëndetësor i vendit ku ka ndodhur lindja e fëmijës, qendra “Shërbimi Ligjor Falas” mbulon shpenzimet për sigurimin e këtij dokumentacioni dhe Ministria e Brendshme bën regjistrimin nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

- **“Certifikatë-Asistencë në lindje”** miratuar nga Ministria e Shëndetësisë në dhjetor 2011 me Urdhër Nr. 508, datë 07.12.2011. Në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme, në këtë dokument, janë shtuar edhe dy elementë shtesë, siç janë numri i identitetit të nënës dhe mbiemri i vajzërisë së saj, duke çuar në një evidentim më të mirë të lindjeve të fëmijëve. Me këto ndryshime dhe përmirësime, kuadri ligjor lidhur me regjistrimin e personave konsiderohet i plotësuar.

Të gjithë masat e mësipërme synojnë të vendosin bashkëpunimin mes Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile (DPGJC) dhe të gjitha institucioneve shtetërore dhe joshetërore, qendrave apo organizatave të ndryshme që veprojnë në vend për të bërë regjistrimin e rasteve të paregjistruara. Secili nga këto institucione apo organizata mund t’i paraqesë DPGJC, listën e emrave të fëmijëve të paregjistruar që kanë identifikuar, si dhe çdo dokument të mundshëm që zotërojnë lidhur me to. Më pas, është DPGJC që merret me zgjidhjen e rastit deri në regjistrimin e tij në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Gjatë periudhës maj 2012-maj 2013 janë regjistruar gjithsej 270 fëmijë, 130 të lindur brenda vendit dhe 140 të lindur jashtë vendit.

Megjithatë në qarqet Vlorë, Berat, Elbasan ka pasur shqetësime lidhur me zbatueshmërinë e procedurave të mësipërme.

Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, abuzimi dhe menaxhimi i rasteve të fëmijëve në rrezik.

Pas rasteve të shumta të fëmijëve të dhunuar në familje apo të abuzuar u ndërmorën ndryshime të rëndësishme në Kodin Penal, kryesisht për të rënduar dënimet për krimet ndaj të miturve.

Janë ndryshuar dhe ashpërsuar dënimet:

- Neni 107/a **“Dhuna seksuale”**
- Neni 108 **“Kryerja e veprave të turpshme”** me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërmëdhjetë vjeç,
- Neni 108/a **“Ngacmimi seksual”**
- Neni 110/b **“Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar”**
- Neni 110/c **“Veprimet që lehtësojnë trafikimin”**
- Neni 114 **“Shfrytëzimi i prostitucionit”**
- Neni 117 **“Pornografia”**
- Neni 130/a, **“Dhuna në familje”**, vendosja e dënimit nga një deri në pesë vjet për dhunë në familje të përsëritur ose në praninë e fëmijëve.
- Neni 124/b **“Keqtrajtimin e të miturve”** është riformuluar sipas të cilit *“Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet”*

Bazuar në ligjin 10347 dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ASHMDF monitoron zbatimin e ligjit dhe funksionimin e të strukturave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor (NJDF, NJMF). ASHMDF ka mbledhur periodikisht (cdo 3 muaj) të dhënat nga NJMF mbi menxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik.

Për periudhën 2012 – prill 2013, në total janë menaxhuar 1333 raste të fëmijëve në rrezik. Nga këto 293 raste janë të reja.

Është duke u përgatitur Protokollin i ri i punës së Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës në bashki/komunë, i cili do të shërbejë si një Udhëzues Metodologjik, në të cilin do të specifikohen në detaje mënyra e ndjekjes së procedurave për menaxhimin e fëmijës në rrezik, të përcaktuara në VKM Nr 265 datë 13.04.2012, duke unifikuar kështu mënyrën e punës së të gjithë NJMF në vend.

Në zbatim të legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve, Minsitri i Punës Cështjeve Sociale dhe Shaseve të Barabarta dhe Ministri i Brendshëm miratuan Urdhërin e përbashkët Nr 125 datë 23.08.2012 *“Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve të cilët janë të ekspozuar ndaj formave të ndryshme të abuzimit ndaj tyre”*. Ky Urdhër mundëson koordinimin dhe bashkërendimin e punës nëpërmjet strukturave të Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit Social Shtetëror me qëllim evidencimin e fëmijëve të rrugës dhe marrjen menjëherë në mbrojtje të tyre.

Në zbatim të këtij urdhëri është hartuar edhe draft-plani i punës ndërinstitucional për mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge, parandalimin e ngjarjeve kriminale ndaj kësaj kategorie të miturish dhe marrja në mbrojtje dhe rehabilitimin e tyre.

Gjithashtu në zbatim të Urdhërit të përbashkët të ministrave, të gjithë shërbimet rezidenciale publike për fëmijë kanë krijuar ambjentete e nevojshme për shërbimin e emergjencës.

Për periudhën Gusht 2012-Prill 2013 pranë Shërbimit Social Shtetëror janë referuar rastet e 54 fëmijëve në situatë rruge, me grupmoshë të ndryshme me kombësi rome/egjiptiane që shfrytëzoheshin në rrugët e Tiranës.

Fëmijët kanë qënë kryesisht nga Tirana dhe janë referuar nga Punonjësit e Policisë së Tiranës, Qendra ARSIS dhe punonjësit e Zyrës Rajonale të SHSSH.

Rreth 18 fëmijë në situatë rruge u sistemuan fillimisht në institucionet e përkujdesit social rezidencial, ndërsa të tjerët pas procedurave verifikuese u kthyen në familje.

5 nga fëmijët e sistemuar në institucionet janë rikthyer në familje dhe u është bërë e njohur prindërve dhe kujdestarëve ligjor, procedura mbi zbatimin e ligjit për mbrojtjen e fëmijëve deri në heqjen e kujdestarisë apo përgjegjësisë prindërore.

Prindërit janë informuar edhe mbi shërbimet dhe ndihmën që mund të marrin në Bashki/Komunë për të shmangur neglizhimin, shfrytëzimin e fëmijëve.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për vitin 2012 janë evidentuar rreth 708 fëmijë të dëmtuar, nga këta 89 fëmijë kanë pësuar dhunë:

- Dhunë në familje 58 fëmijë
- Shfrytëzim seksual 22 fëmijë
- Keqtrajtim 5 fëmijë
- Trafikim 4 fëmijë

Fëmijët që punojnë

Inspektoriati Shtetëror i Punës monitoron punën e fëmijëve në sektorin formal të ekonomisë. Në bazë të inspektimeve të ISHP-së për vitin 2012 rezulton se janë të punësuar në total 319 fëmijë, ndërsa 1 vit më parë kjo shifër ka qënë 280.

Sipas moshës së tyre:

16 vjeç	56 fëmijë.	ose	17.5 %.
17 vjeç	221 fëmijë.	ose	69.3 %.
18 vjeç	42 fëmijë.	ose	13.2 %.

Shumica e fëmijëve të evidentuar janë të seksit femër, 230 ose 72.1% e fëmijëve, ndërsa meshkuj janë 89.

Aktivitetet e punësimit	Numri i fëmijëve
Përpunim peshku	36
Prodhim këpucësh	16
Konfeksione	90

Tregëti shumicë e pakicë Hotel-Bar-Restorante	22
Transport, telekomunikacion	38
Financë, shërbime të sigurimeve	31
Aktivitete të tjera	86
Total	319

Burimi: ISHP

Në kuadër të ruajtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë të fëmijëve ekonomikisht aktive, nga inspektimet rezulton se janë identifikuar:

- Ekzaminim mjekësor

Me ekzaminim mjekësor 285 fëmijë ose 89.3 %

Pa ekzaminim mjekësor 34 fëmijë

- Sigurime

Të siguruar 275 fëmijë ose 86.2 % e fëmijëve.

Të pa siguruar 44 fëmijë

- Autorizimi i ISHP-së:

Pa autorizim 25 fëmijë ose 7.8% e fëmijëve.

Me autorizim 294 fëmijë

Zbatimi i Programit COMBI: “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve positive”

Në vijim të zbatimit të Programin Kombëtar Kombi “Për një shkollë miqësore pro sjelljeve pozitive”, në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar është ngritur dhe po vazhdon funksionimi i rrjetit të avokatëve të “Mënyrave të Reja të Disiplinimit” (MRD)

Mësuesit e shkollave mbledhen periodikisht dhe trajtojnë raste të përdorimit të MRD. Pjesë e këtyre veprimtarive janë dhe nxënësit e shkollës si dhe komuniteti i prindërve.

Në vazhdimësi po monitorohet ndryshimi i sjelljes së nxënësve, të dhëna këto që do të përpunohen dhe do të krahasohen me treguesit në fillim të projektit.

Vendosja dhe konsolidimi i shërbimit psikologjik në të gjitha kopshtet, shkollat e arsimit të detyruar dhe arsimit të mesëm

Në zbatim të Ligjit për Arsimin Parauniversitar 69/2012, shkolla nuk ofron vetëm shërbim psikologjik por dhe shërbim të punonjësit social. Gjatë këtij viti është punuar për hartimin e akteve nënligjore të cilat po riorientojnë funksionin e këtij shërbimi duke e pasuruar edhe me shërbimin e punonjësit social.

Aktualisht shërbimi psikologjik funksionon në të gjithë zonën urbane të vendit dhe hap pas hapi po shtrihet dhe në zonën rurale, fillimisht në shkolla me numër të lartë të nxënësve.

Internet i sigurtë për fëmijët

Me rritjen e aksesit të fëmijëve në internet, shërbimet dhe rrjetet e komunikimeve elektronike, ka lindur nevoja për vendosjen e rregullave me qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga informacioni i dëmshëm që mund të qarkullojë nga këto burime informacioni.

Me VKM Nr 182 datë 13.03.2013 u miratua Kodi i Sjelljes “Për përdorim të sigurtë dhe të përgjegjshëm të rrjeteve të komunikimeve elektronike” ndërmjet operatorëve të komunikimeve elektronike. AKSHI në bashkëpunim me MITIK koordinuan procesin për hartimin dhe miratimin e Kodit të Sjelljes, i cili u nënshkrua në 7 shkurt 2013 nga operatorët kryesorë të komunikimeve elektronike në vend, sipërmarrësit si : AMC, Vodafone Albania, Eagle Mobile, Plus, Shoqata Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit (AITA) si dhe ISP Provider: Albtelecom, Abcom, Abissnet, Tring Communication.

Aktualisht në Shqipëri nuk ekzistojnë standarde dhe rregullore të qarta në lidhje me klasifikimin e përmbajtjes komerciale dhe sipërmarrësit e mësipërm pranojnë se nuk kanë kontroll mbi përmbajtjen që ofrohet në internet, por nëpërmjet këtij Kodi ata sigurojnë që përmbajtja komerciale e ofruar nga ose nëpërmjet tyre do të kontrollohet e do të klasifikohet brenda një kuadri të përshtatshëm. Përmbajtja komerciale do të “shënjohe” për të dalluar nëse është i përshtatshëm për moshën nën 18 vjeç. Sipas këtij Kodi sipërmarrësit angazhohen të ndihmojnë fëmijët dhe prindërit lidhur me përdorimin e rrjeteve apo shërbimet e internetit, duke pasqyruar Udhëzimet për prindërit në faqet e tyre të internetit.

Kodi i sjelljes së këtyre operatorëve është një hap i pare, por mbetet me rëndësi hartimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm për të siguruar internet të sigurtë për fëmijët.

KAPITULLI 3

E DREJTA PËR ZHVILLIM DHE ARSIM

Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët

Në kuadër të konsolidimit të sistemit arsimor 9-vjeçar, MASH vlerëson se 86% e fëmijëve që janë regjistruar në klasën e parë kanë ndjekur të paktën 1 vit përgatitor, duke ju siguruar potencialisht shanset për një mbarëvajtje më të mirë në klasën e parë. MASH vlerëson që rreth 70% e fëmijëve 3-5 vjeçar ndjekin kopshtin.

Buxheti i arsimit bazë ndaj buxhetit total zë rreth 61% të fondeve të arsimit. Investimet dhe ndërhyrjet në arsimin bazë po përqendrohen në përmirësimin e infrastrukturës fizike dhe pajisjen e shkollave me laboratorë.

Në kuadër të gjithëpërfshirjes së fëmijëve në mësimnxënie i është kushtuar vëmendje ndjekjes dhe regjistrimit të fëmijëve romë në arsimin parashkollor dhe atë të detyruar, rritjes së e numrit të nxënësve romë që ndjekin “Shansin e Dytë” (66% e nxënësve janë romë).

Konkretisht në vitin shkollor 2012-2013 :


Arsimin parashkollor e ndjekin **664 fëmijë romë**; dhe arsimin e detyruar e ndjekin **3231 rome**

Të gjithë fëmijëve romë përfitojnë rimbursimin 100% të teksteve shkollore.

Ulja e nivelit të braktisjes së shkollës

Treguesi zyrtar i braktisjes shkollore për periudhën 2011-2012, vlerësohet të jetë 0.37%, sipas të dhënave të MASH.

Përqindja më e lartë e braktisjes shkollore në shkallë vendi rezulton të jetë më e lartë për ciklin e lartë të arsimit të detyrueshëm, rreth 0.5 %. dhe 0.24% për ciklin e ulët.




Burimi MASH

KAPITULLI 4

E DREJTA PËR KUJDES SHËNDETËSOR

Sigurimi i kujdesit esencial shëndetësor për nënën dhe fëmijën



Burimi: MSH

Në vitin 2012, vdekshmëria foshnjore është 7.8 vdekje për 1000, ndërsa në 2011 ishte 8.7/1000 LGJ sipas statistikave të ministrisë së shëndetësisë.

Vdekshmëria amtare

Sipas të dhënave të fundit të statistikave administrative të Ministrisë së Shëndetësisë, për 2012 vdekshmëria amtare rezulton e ulur në 5.7 vdekje në 100 mijë lindje, krahasuar me vitin 2005 ku kjo shifër ishte 23 vdekje për 100 000 lindje gjalle.

Jane perfunduar protokollat per kujdesin per gruan shtatzene dhe kujdesin per te porsalindurin, kujdesi perinatal dhe protokollat e kujdesit antenatal

Në bashkëpunim me OBSH u adoptua edhe protokollin për vlerësimin e cilësisë së kujdesit për nënën dhe të porsalindurin në maternitete, si një mjet i unifikuar për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve mbi bazën e standarteve ndërkombëtare.

Janë përpiluar 15 protokolle klinike kombëtare për obstetrikën dhe neonatologjinë si dhe 27 protokolle klinike për pediatri të akredituara nga Qendra Kombëtare e Akreditimit dhe Cilësisë.

Ushqyerja

Për vitin 2012, 64.6 % e fëmijëve të lindur janë ushqyer vetem me gjë gjatë 6 muajve të parë të jetës së tyre.

Gjate periudhës maj 2012-maj 2013 vazhdoi vlerësimi i materniteteve të rretheve Gjirokaster, Korce, Vlora, Shkodra, Fier për ti certifikuar si institucione që mbrojnë dhe nxisin ushqyerjen me gjë. Aktualisht janë 8 maternitete të certifikuara. Treguesit e ushqyerjes me gjë janë përfshirë tashmë në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të punës së institucioneve të kujdesit shëndetësor për nënën dhe fëmijën

Është duke u hartuar plani i ri kombëtar për ushqyerjen dhe ushqimin. Aktualisht ka përfunduar drafti i parë.

Janë hartuar kurbat e reja të rritjes së fëmijës, sipas OBSH dhe janë hartuar Udhëzuesit dietetikë për ushqyerjen e gruas shtatzënë dhe ushqyerjen e fëmijës.

Ka filluar puna për përcaktimin e treguesve lidhur me ushqyerjen e fëmijës që do të përfshihen në sistemin e monitorimit të performancës së qendrave shëndetësore. Ky proces pritet të përfundojë në vitin 2014

Instituti i Zhvillimit Arsimor në bashkëpunim me ISHP dhe me mbështetjen e UNICEF, ka përfunduar paketën kurrikulare për edukimin e Ushqyerjes së Shëndetshme në arsimin e detyruar (Klasa 1-9), që fillimisht do të pilotohet në disa shkolla të qarkut Shkodër.

Parandalimi i sëmundjeve ngjitëse dhe reduktimi i nivelit të sëmundjeve kryesore të fëmijërisë

Përqindja e fëmijëve të vaksinuar sipas kalendarit rutinë vazhdon të jete mbi 97%.

Drejtoritë e Shëndetit Publik të rretheve janë të udhëzuar që të kenë në vëmendje të veçantë imunizimin dhe trajtimin shëndetësor të grupeve të komunitetit rom.

Ministria e Shëndetësisë, Instituti i Shëndetit Publik në bashkëpunim me organizatat Rome, kanë krijuar një bazë të dhënash me zonat e banuara nga komuniteti Rom (hartë e zonave Rome) në të gjithë vendin. Janë kryer fushata vaksinimi të fëmijëve romë në Tiranë, Shkodër, Fier

Kontrolli dhe parandalimi HIV/AIDS dhe IST

Në Shqipëri, në periudhën Janar–Dhjetor 2012 janë identifikuar 70 raste të reja të diagnostikuara me HIV/AIDS, duke e çuar shifrën totale të rasteve të prekura nga HIV/AIDS në vendin tonë, në 555 raste.

Per periudhën Maj 2012-Maj 2013, janë diagnostikuar 5 femje me HIV. 3 prej tyre janë infektuar përmes rruges vertikale (transmetim nga nëna te femija).

Trajtimi i femijeve me HIV/AIDS bëhet në Sherbimin e Pediatrisë në QSUT. Gjatë këtij viti, në Sherbimin Infektiv në QSUT është trajtur rasti i një gruaje shtatzene për parandalimin e transmetimit të infeksionit HIV/AIDS nga nëna te femija.

Qendra Kombëtare e referencës për parandalimin e transmetimit të Hiv nga nëna te femija është e vendosur pranë Spitalit Obstetrik-Gjinekologjik “Koco Gliozheni” në Tiranë.


KAPITULLI 5

E DREJTA PËR MBROJTJE LIGJORE


Fëmijët në konflikt me ligjin

Gjatë 2012 janë evidentuar nga strukturat e policisë 2142 fëmijë autorë në vepra penale të ndryshme, prej të cilëve 2126 fëmijë janë evidentuar nga strukturat e policisë në qarqe dhe 16 janë evidentuar nga strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit

Femije te denoncuar



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, 381 fëmijë janë autorë të krimeve të rënda. Pjesa më e madhe e tyre, rreth 215 fëmijë janë denoncuar si autorë të krimeve në fushën e drogës, e më pas vijnë krimet kundër pronës dhe krimet kundër personit.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, gjatë gjashtëmuajorit të parë të 2012 janë dënuar nga gjykata 380 të mitur që përbëjnë rreth 8 % të të dënuarve në total. Kryesisht masa e dënimit të të miturve ka qënë deri në 2 vjet. Numri më i madh i të miturve, janë dënuar për veprën penale të vjedhjes së pasurisë, rreth 263 të dënuar.

Garantimi i arsimit të detyrueshëm dhe shkollimi i fëmijëve në paraburgim dhe në burgje

Në zbatim të Memorandumit të nënshkruar midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit, për hapjen e ciklit të detyruar shkollor 9 vjeçar në sistemin e burgjeve, të miturit e paraburgosur, të regjistruar për fillimin e procesit arsimor, do të kenë mundësinë të ndjekin arsimin e detyruar 9 vjeçar deri në momentin e marrjes së vendimit gjyqësor të formës së prerë. Në rast marrje vendimi për dënimin e të miturit, të miturit do të vazhdojnë procesin arsimor në Institutin e të miturve në Kavajë. Dhe në rast lirimi, pranë qendrave të tyre të banimit. Në përfundim të shkollës, të gjithë të dënuarit pajisen me dëftesë sipas shkollës që janë të regjistruar. Ky është një element i rëndësishëm, pasi dëftesa e marrë nuk njihet si dëftesë e ndjekjes së procesit shkollor në kushtet e burgut, duke eliminuar në këtë mënyrë çdo formë diskriminimi.

Sigurimi i mbrojtjes së duhur për fëmijët nën moshën 14 vjeç në konflikt me ligjin

Ka filluar pershtatja e ambienteve të policisë ku intervistohen dhe mbahen të miturit, në mjedise miqësore për të mitur. Në 18 qershor 2012 është nënshkruar Marrëveshja e Bashkepunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe organizatës Save the Children "Për sigurimin e ambienteve të posaçme për intervistimin e të miturve viktime, dëshmitarë dhe/ose të implikuar në krime, duke u bazuar në praktikën më të mirë ndërkombëtare në këtë drejtim".

Qëllimi i kësaj marrëveshje është implementimi i praktikave më të mira bashkëkohore të intervistimit të të miturve viktime, dëshmitarë të krimeve, si dhe të miturve të implikuar, duke krijuar ambiente të posaçme për intervistimin e tyre. Aktualisht janë në fazën e përfundimit tre ambiente të tilla në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Shkoder, Drejtorinë e Policisë së Qarkut Fier dhe Komisarjatit të Policisë së Korçës .

Në qershor 2012 ka përfunduar fazën e dytë të trajnimit të punonjësve të policisë lidhur me metodat e intervistimit të të miturve të denuar organizuar nga Qendra e Formimit Policor dhe u mbështetur nga Zyra e OSBE-se në Shqipëri në bashkëpunim me Ambasadën Franceze.

Mbrojtja e fëmijëve viktime dhe dëshmitarë të krimit

Me ligjin 144 datë 2.05.2013 janë miratuar ndryshime në Kodin Penal .

Ndryshimet kanë sjellë:

- Ashpërsim të dënimeve lidhur veprat penale të dhunës e ngacmimeve seksuale ndaj të miturve
- Në nenet 114 dhe 117 lidhur me shfrytëzimin e prostitucionit dhe pornografisë, janë shtuar dispozita kur këto krime ndodhin ndaj të miturve
- Është riformuluar neni 124/b lidhur me keqtrajtimin e të miturve sipas të cilit Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë në bashkëpunim me Qendrën për Praktika dhe Shërbime Ligjore të Integruara, ka punuar për përgatitjen e një drafti Udhezuesi për Punonjësit e Policisë, mbi "Detajimin e të drejtave të të miturve të pandehur, viktime dhe dëshmitarë në fazën e hetimit dhe teknikat miqësore të intervistimit të të miturve si të pandehur, viktime dhe dëshmitarë". Aktualisht Udhezuesi është në fazën përfundimtare dhe mendohet të përdoret edhe si Procedure Standarte Pune.